

## **GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS**

**P.nr.381/13**

**29 maj 2015**

[Aktgjykimi i publikuar mund të mos jetë i formës së prere dhe mund të jetë objekt i ankesës në bazë të ligjit të aplikueshëm]

### **NË EMER TË POPULLIT**

Gjykata Themelore e Prishtinës, me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Mariola Pasnik, si Kryetare e trupit gjykues, gjyqtarja e Kosovës Suzana Qerkini dhe gjyqtari i EULEX-it Arkadiusz Sedek, si anëtarë të trupit gjykues, me ndihmën e procesmbajtësit Muhamet Musliu, në çështjen penale kundër:

- 1. I.K.**, i biri i XXX, i lindur me XXX në fshatin XXX, Kamenicë, Numri i KI XXX, Kapiten i policisë, aktualisht banon në Fushe Kosovë, XXX, mashkull, i martuar, 3 fëmijë, shqiptar i Kosovës;

I akuzuar në propozim akuzën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, me numër reference PPS 4/10 të datës 27 tetor 2011 për veprën penale të *Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit* në kundërshtim me nenin 339 paragrafi 1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës ( në tekstin e mëtejshëm "KPK 2003"); dhe me veprën penale të *Falsifikim i dokumenteve zyrtare* në shkelje të nenit 348 paragrafi 1 i KPK 2003;

Pas mbajtjes së seancave gjyqësore me datën 1 dhe 3 dhjetor 2014, 19 shkurt 2015, 16 prill 2015 dhe më 27 maj 2015;

Pas shqyrtimit dhe votimit që u mbajt me 27 maj 2015;

Në praninë e të pandehurit dhe prokurorit, në pajtim me nenin 359 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës nr. 04/L-123 (në tekstin e mëtejshëm "KPK"), në publik, më 29 maj 2015 lëshon këtë:

## AKTGJYKIM

### I.

Në bazë të nenit 363 par. 1.3 të KPP-së, në lidhje me pikën 1 të aktakuzës, akuza:

### REFUZOHET

#### Sepse:

Afati i parashkrimit ka kaluar. Vepra *Shpërdorimi i pozitës zyrtare* sanksionohet me burgim deri në një vit në pajtim me nenin 339 (1) KPK 2003, ndërsa me 6 muaj deri në 5 vjet sipas nenit 422 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ("KPRK"). Prandaj, zbatohet KPK i vitit 2003 si ligji më i favorshëm për të pandehurin (neni 3 par. 2 të *Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit* KPRK.) Afati i parashkrimit për një vepër penale të dënueshme me burgim deri në një vit është 2 vite. Ndjekja penale duhet të përfundon në çdo rast ku afati i parashkrimit ka kaluar dy herë (neni 90 par. 1.6 neni 91 (6) KPK 2003). Vepra penale e Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare, siç pretendohet në Pikën 1 është kryer në shtator të vitit 2010. Afati i parashkrimit ka kaluar dy herë dhe për këtë arsye është refuzuar pika 1 e propozimkuzës.

\* \* \*

### II.

Në bazë të nenit 365 të KPP-së, në lidhje me Pikën 2 të aktakuzës, i pandehuri I.K. shpallet:

### FAJTOR

#### Sepse:

Në shtator të vitit 2010, derisa punonte si person zyrtar për Policinë e Kosovës dhe mbante pozitën e shefit të Njesisë për Autorizimin e Armëve i ka falsifikuar dokumente zyrtare vijuese, përkatësisht "Vendimet për bartjen e armës së brezit" të renditura me numrin e dokumentit si më poshtë: 02B0075, 10B0091, 10C0053,

10B0084 dhe 10C0026 duke futur qëllimisht përmbajtje të rreme në këto dokumente zyrtare.

Në këtë mënyrë, i pandehuri I.K. ka kryer veprën penale të Falsifikimit të dokumenteve zyrtare në kundërshtim me nenin 348 (1) të KPK 2003.

\*\*\*

Prandaj, sipas dispozitave të nenit 3 par. 2 të KPRK dhe neneve 36 (2), 38 (1, 2), 39 (1, 2), 41(1.1), 42, 43, 44, 54 (2.1) dhe 348 (1) të KPK 2003 dhe neneve 359, 361, 365 par.1, 366 të KPK, Gjykata e shqipton dënimin si në vijim:

#### **I.K.**

- Për veprën penale nën pikën II të këtij aktgjykimi, dënohet me **një (1) vit burgim me kusht për një periudhë verifikuese prej dy (2) viteve.** Ky dënim nuk do të zbatohet nëse i akuzuari nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale për periudhën e verifikimit.

- Përveç kësaj i pandehuri gjobitet me shumën prej dyqind e pesëdhjetë (250) euro që duhet të paguhet brenda dy (2) muajve pasi që vendimi të bëhet i formës së prerë;

\*\*\*

#### **III.**

Sipas nenit 450(2) dhe 453(1) të KPK-së i pandehuri është i detyruar që të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 150 euro, e cila shumë duhet të paguhet brenda 15 ditëve pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

\*\*\*

#### **IV.**

Pala e dëmtuar mund të paraqesë kërkesë për kompensim në procedurën civile.

## ARSYETIMI:

I.Historiku procedural: .....	5
II.Ligji procedural i aplikueshëm:.....	6
III.Gjendja faktike e vërtetuar nga trupi gjykues: .....	6
IV.Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor: .....	9
V.Vlerësimi i provave: .....	9
<i>Dëshmia e dëshmitares T.C.</i> .....	9
<i>Dëshmia e dëshmitares Z.K.</i> .....	10
<i>Dëshmia e dëshmitarit E.A.</i> .....	13
<i>Dëshmia e dëshmitarit A.R.</i> .....	14
<i>Dëshmia e dëshmitares eksperte N.I.</i> .....	15
<i>Dëshmia e të pandehurit I.K.</i> .....	16
<i>Provat materiale</i> .....	17
VI.Kualifikimi Ligjor:.....	18
VII.Dënimi: .....	19
VIII.Shpenzimet e procedurës penale gjyqësore: .....	19
IX.Kërkesa pasurore juridike: .....	19
X.Përfundim:.....	19

## **I. Historiku procedural:**

1. Me 25 janar 2011 Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ka lëshuar një Aktvendim mbi fillimin e hetimeve (AiH) kundër të pandehurit I.K. i cili dyshohej se ka kryer veprat penale të Shpërdorimit të pozitës zyrtare ose autorizimit në kundërshtim me nenin 339 të KPK-së (2003) dhe për veprën penale të Falsifikimit të dokumenteve zyrtare, në kundërshtim me nenin 348 të KPK-së (2003).
2. Me 14 korrik 2011 Gjykata e Qarkut në Prishtinë, duke vepruar sipas kërkesës së PSRK-së të datës 8 korrik 2011, ka lëshuar një aktvendim për të zgjatur periudhën e hetimit deri më 25 janar 2012.
3. Më 1 nëntor 2011 PSRK ka ngritur një propozim akuzë kundër të pandehurit. Aktakuza e ngarkonte të pandehurin me dy pika: Pika 1: Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose autorizimit, në kundërshtim me nenin 339 (1) të KPK-së (2003) dhe Pika 2: Falsifikim i dokumenteve zyrtare, në kundërshtim me nenin 348 (1) të KPK-së (2003).
4. Më 26 mars 2014 u mbajt një seancë fillestare. Të pandehurit i është dhënë mundësia që të paraqesë një kundërshtim kundër aktakuzës apo provave.
5. Më 24 prill 2014 i pandehuri ka paraqitur një kundërshtim duke kërkuar disa prova të shpallen të papranueshme dhe ka kërkuar nga kryetari i trupit gjykues që të hedh poshtë aktakuzën.
6. Më 28 maj 2014 kryetari i trupit gjykues e refuzoi kërkesën e të pandehurit si të pabazuar.
7. Më 17 qershor 2014 i pandehuri parashtrroi një ankesë duke e atakuar vendimin e kryetarit të trupit gjykues për të refuzuar kërkesën e tij duke kërkuar nga gjykata që të deklarojë provat caktuara si të papranueshme dhe për më tepër të hedh poshtë aktakuzën.
8. Më 24 korrik 2014 Gjykata e Apelit e hodhi poshtë ankesën e të pandehurit dhe e pranoi vendimin e kryetarit të trupit gjykues.

9. Më 1 dhe 3 dhjetor 2014, 19 shkurt 2015, 16 prill 2015, 27 Maj 2015 janë mbajtur seancat e shqyrtimit kryesor.
10. Më 29 maj 2015 trupi gjykues e shpalli vendimin e tij si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **II. Ligji procedural i aplikueshëm:**

11. Sipas nenit 541 të KPPK-së procedura penale në të cilën është ngritur aktakuza por nuk është konfirmuar para hyrjes në fuqi të këtij kodi, do të trajtohet në bazë të dispozitave të kodit të ri. Në këtë rast propozim akuza ishte ngritur në kohën kur KPPK i ri nuk ishte në fuqi, por shqyrtimi gjyqesor filloi në kohën kur KPPK i ri ishte në fuqi. Prandaj, procedurat do të zhvillohet në bazë të KPPK të ri.

## **III. Gjendja faktike e vërtetuar nga trupi gjykues:**

12. Pretendimet faktike që janë ngritur në Pikën 1 të propozim akuzës janë kualifikuar nga prokuroria të jetë në kundërshtim me nenin 339 (1) të KPK-së 2003. Pasi që ekziston një pengesë absolute për të ndjekur penalisht këtë veprë penale gjykata e refuzoi këtë pikë të akuzës pa hyrë në meritat e çështjes.
13. Lidhur me pretendimet e ngritura në Pikën 2 të aktakuzës gjykata i vërtetoj përtej çdo dyshimi të arsyeshëm faktet e mëposhtme:
14. Në shtator të vitit 2010 i pandehuri I.K. ishte duke punuar për Policinë e Kosovës si udhëheqës i Njesisë së Autorizimit të Armëve. Kjo njësi ka qenë pjesë e departamentit Drejtorisë për Shërbime të Brendshme kryesues e të cilit ishte Z.K. Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme ishte pjesë e Departamentit të personelit dhe Administratës e cila udhëhiqej nga T.C.. Këto janë fakte të njohura të cilat nuk janë kontestuar nga askush në këtë procedurë.
15. Sipas procedurave standarde të veprimit (PSV) e quajtur "Procedura për lëshimin e Kartelave Autorizuese për Armë për Mbrojtje Personale" Shefi i

Njësisë për Autorizimin e Armëve, pra i pandehuri I.K., ka pasur përgjegjësinë e mëposhtme:

*“10. Pas përfundimit të të gjitha hapave dhe procedurave të përmendura më lart, shefi i NJAA e dërgon kërkesën së bashku me të gjitha raportet tek drejtori i Shërbimeve të Brendshme apo të deleguarit të tij/saj për rekomandim, dhe drejtori do t'ia përcjellë atë shefit të Departamentit për Personel të SHPK-së.*

*11. Drejtori i Shërbimeve të Brendshme të SHPK-së e shqyrton kërkesën dhe e bën rekomandimin e tij/saj, dhe ia e dërgon atë Shefit të Departamentit të Personelit të SHPK-së, për vendim.*

*12. Pastaj Shef i Departamentit për Personel të SHPK-së ia kthen dosjen e aplikimit së bashku me vendimin e tij/saj të nënshkruar, përmes zinxhirit komandues, shefit të NJAA.”*

16. Prandaj, siç mund të vërehet nga gjuha e PSV e mësipërme, i pandehuri I.K. nuk ka pasur autoritet as për të dhënë rekomandime, e as për të vendosur nëse një kërkesë duhet të miratohet apo refuzohet. Detyra e tij ishte që të përgatiste kërkesën me të gjitha dokumentet e nevojshme dhe ta dërgonte atë në Drejtorin e Shërbimeve të Brendshme, e cila në këtë rast ishte Z.K.. Kjo e fundit ishte përgjegjëse për të bërë një rekomandim në lidhje me kërkesën dhe pastaj në fund kryesuesja e departamentit të personelit, e cila në këtë rast ishte T.C., kishte autoritetin të lëshojë vendimin përfundimtar për ta miratuar ose refuzuar një kërkesë të caktuar.
17. Në shtator të vitit 2010, i pandehuri nuk ishte duke vepruar si shef i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme apo Shef i Departamentit për Administratë dhe Personel. Ndonëse i pandehuri pretendon se disa herë ai ka vepruar si ushtrues detyre i shefit të Shërbimeve të Brendshme, në shtator të vitit 2010, ky nuk ishte rasti. Kjo është konfirmuar nga dëshmitarët T.C. dhe Z.K. Përveç kësaj, nëse ai ishte duke vepruar si ushtrues detyre në një nga këto pozita nuk do të kishte qenë e nevojshme për të ndryshuar nënshkrimin për ta bërë atë të duket si nënshkrimi i Z.K., por përkundrazi do të nënshkruante me nënshkrimin e tij. Për më tepër, i pandehuri ka pohuar se ai nuk i ka nënshkruar këto dokumente dhe kjo është hedhur poshtë krejtësisht nga rezultatet e ekspertizës.
18. Në shtator të vitit 2010 dokumentet vijuese zyrtare të Policisë së Kosovës janë falsifikuar: 02B0075, 10B0091, 10C0053, 10B0084 dhe 10C0026. Këto

dokumente kishin dy vende për nënshkrim: vija e parë ishte e rezervuar për nënshkrimin e shefit të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme (ose ushtruesin e detyrës), e cila në atë kohë ishte Z.K. dhe vija e dytë ishte e rezervuar për nënshkrimin e shefit të Departamentit për Administratë dhe Personel (ose ushtruesin e detyrës), e cila në atë kohë ishte T.C.

- Në dokumentin **02B0075** i pandehuri e falsifikoi nënshkrimin e Z.K. dy herë. Në rreshtin e parë duke pretenduar të jetë nënshkrimi i Z.K., ndërsa në rreshtin e dytë duke pretenduar të jetë Z.K. që nënshkruan në emër të T.C.
  - Në dokumentin **10B0091** i pandehuri në rreshtin e parë ka nënshkruar si ushtrues detyre i Shefit të Shërbimeve të Brendshme, ndërsa në rreshtin e dytë ai e ka falsifikuar nënshkrimin e Z.K. duke pretenduar se nënshkruan në emër të T.C.;
  - Në dokumentin **10C0053** i pandehuri në rreshtin e parë ka nënshkruar si ushtrues detyre i Shefit të Shërbimeve të Brendshme, ndërsa në rreshtin e dytë ai e ka falsifikuar nënshkrimin e Z.K. duke pretenduar se nënshkruan në emër të T.C.;
  - Në dokumentin **10B0084** i pandehuri në rreshtin e parë e ka falsifikuar nënshkrimin e Z.K., ndërsa nënshkrimi në rreshtin e dytë është po ashtu i falsifikuar, por ekspertiza nuk ka mundur të vijë në përfundim se kush e ka shkruar këtë nënshkrim.
  - Në dokumentin **10C0026** i pandehuri në rreshtin e parë ka nënshkruar si ushtrues detyre i Shefit të Shërbimeve të Brendshme, ndërsa në rreshtin e dytë ai e ka falsifikuar nënshkrimin e Z.K. duke pretenduar se nënshkruan në emër të T.C.
19. I pandehuri në deklaratën e tij të dhënë për PSRK-në, dhe në shqyrtimit kryesore ka pohuar se qëndron pas saj, ka pranuar pjesërisht se ka nënshkruar disa prej dokumenteve të përmendura më lart.



20. Prandaj, duke u bazuar në ekspertizën e grafologut, deklaratat e T.C. dhe Z.K., si dhe deklarata e të pandehurit I.K., gjykata arrin në përfundimin përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri në shtator të vitit 2010, ndërsa punonte si një person zyrtar për Policinë e Kosovës dhe mbante pozitën e shefit të Njesisë së Autorizimit të Armëve i ka falsifikuar këto dokumente zyrtare, përkatësisht “Vendimet për bartjen e armës së brezit” të renditura me numra të dokumentit si më poshtë: : 02B0075, 10B0091, 10C0053, 10B0084 dhe 10C0026 duke futur me dashje përmbajtje të qëllimisht në këto dokumente zyrtare.

#### **IV. Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor:**

21. Trupi gjykues gjatë shqyrtimit gjyqësor ka administruar provat si në vijim:
- Raportet policore nga bastisja e zyrës se të pandehurit;
  - Raportin e forensikes të datës 4 tetor 2011;
  - Vendimin për autorizimin e armës nr. 02B0075, të datës 13 shtator 2010;
  - Vendimin për autorizimin e armës nr. 10B0091, të datës 21 prill 2010
  - Vendimin për autorizimin e armës nr. 10C0053, të datës 20 prill 2010;
  - Vendimin për autorizimin e armës nr. 10B0084, të datës 5,6 korrik 2010;
  - Rekomandimin për autorizimin e armës nr. 0B0084 të datës 5 korrik 2010;
  - Vendimin për autorizimin e armës nr. 10C0026, të datës 21 prill 2010;
  - Deklarata e dëshmitarit I.R., e datës 3 shkurt 2011;
  - Deklarata e dëshmitares H.L., e datës 4 shkurt 2011;
  - Deklarata e dëshmitares Z.K., e datës 8 dhjetor 2010;
  - Deklarata e dëshmitares Z.K., e datës 7 shkurt 2011;
  - Deklarata e dëshmitares T.C., e datës 8 dhjetor 2010;
  - Deklarata e dëshmitares T.C., e datës 22 shkurt 2011;
  - Deklarata e të pandehurit I.K., e datës 18 mars 2011.

#### **V. Vlerësimi i provave:**

##### *Dëshmia e dëshmitares T.C.*

22. Dëshmitarja dëshmoi tri herë gjatë kësaj procedure penale: një herë para

Policisë së Kosovës më 8 dhjetor 2010, herën e dytë para prokurorit të PSRK më 22 shkurt 2011 dhe herën e tretë ajo dëshmoi para trupit gjykues më 1 dhjetor 2014. Përmbledhja e këtyre tri deklaratave përputhet. Në përmbledhje dëshmitarja ka dëshmuar si më poshtë:

23. Në shtator 2010 dëshmitarja ka punuar me Policinë e Kosovës si udhëheqëse e Departamentit të Personelit dhe Administratës. Përgjegjësia e saj ishte që të menaxhoi Drejtorinë e Drejtorisë së Personelit të Shërbimeve Shëndetësore dhe Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme. Njësia për Autorizimin e Armëve ishte pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme. Sipas dëshmitares ajo ishte autoriteti i fundit për të miratuar apo refuzojë kërkesat për autorizim të armëve.
24. Gjatë shtatorit të vitit 2010, dëshmitarja i ka vërejtur disa parregullsi në lëshimin e autorizimeve për bartjen e armëve. Veçanërisht, në dokumentet që përbënin kërkesën e aplikantit R.A. ajo vërejti se në vend të nënshkrimit të saj ishte nënshkrimi i Nënkoloneles Z.K. Ajo iu afrua Nënkoloneles Z.K. dhe e pyeti në lidhje me nënshkrimin. Kjo e fundit e informoi dëshmitaren se nënshkrimi i lartpërmendur nuk ishte i saj. Në atë çast dëshmitarja e informoi eprorin e saj R.S. dhe në të njëjtën kohë ajo propozoi që të kryhet një hetim nga personat kompetent. Dëshmitarja dyshoi se përveç nënshkrimit të falsifikuar ka pasur edhe disa parregullsi me vulën që gjithashtu.
25. Në fund dëshmitarja dëshmoi se asnjë prej nënshkrimeve në dokumentet zyrtare të Policisë së Kosovës në vijim 02B0075, 10B0091, 10C0053, 10B0084 dhe 10C0026 nuk ishin nënshkrimet e saj.
26. Dëshmia e kësaj dëshmitareje është e besueshme. Kjo deklaratë përputhet me deklaratën e dëshmitares Z.K., si dhe rezultatet e ekspertizës.

#### ***Dëshmia e dëshmitares Z.K.***

27. Dëshmitarja dëshmoi tri herë në këtë procedurë penale: një herë para Policisë së Kosovës më 18 nëntor 2010, herën e dytë para prokurorit të PSRK më 7 Shkurt 2011, dhe herën e tretë ajo dëshmoi para trupit gjykues më 1 dhjetor 2014. Përmbledhja e këtyre tri deklaratave ka mospërputhje të vogla. Në përmbledhje

dëshmitarja dëshmoi si më poshtë:

28. Dëshmitarja është zyrtare e Policisë së Kosovës dhe gjatë vitit 2010 ajo ka qenë Shefe e Departamentit të Shërbimeve të Brendshme. Ajo ishte përgjegjëse për dhënien e rekomandimeve për lëshimin e autorizimit për përdorimin e armëve dhe në të njëjtën kohë ajo ishte mbikëqyrëse e tërë procesit nga momenti i parashtrimit të kërkesës nga aplikantët në Njësinë për Autorizim të Armëve. Dëshmitarja dëshmoi se i pandehuri I.K. gjatë vitit 2010 ka qenë shef i Njesisë për Autorizim të Armëve.
29. Më 20 shtator 2010, dëshmitarja bisedoi me dëshmitaren T.C. Kjo e fundit e pyeti me zemërim se përse ajo kishte nënshkruar në emër të saj, derisa dëshmitarja T.C. ishte në punë. Pasi që dëshmitarja i shikoi dokumentet që ia tregoi asaj T.C. ajo e vërejti se këto nënshkrime nuk ishin të saj. Dëshmitarja i kontrolloi të gjitha dosjet e saj dhe vërejti se pesë raste asaj i dukeshin të dyshimta. Dëshmitarja iu afrua të pandehurit I.K. dhe e pyeti "Kapiten përse e ke bërë këtë, pse?", dhe ai u përgjigj "një punë, ai tha Daut Haradinaj",
30. Dëshmitarja dëshmoi se ajo nuk i njej nënshkrimet në dokumentet 10B0091, 10B0084, ndërsa për nënshkrimet në dokumentet 10C0053, 10C0086, dëshmitarja nuk ishte e sigurt. Dëshmitarja deklaroi se ajo nuk e ka autorizuar të pandehurin që të nënshkruaj në emër të saj.
31. Dëshmia e kësaj dëshmitareje është e besueshme. Ajo vërteton deklaratën e dëshmitares T.C., si dhe rezultatet e ekspertizës.

#### ***Dëshmia e dëshmitarit I.R.***

32. Dëshmitari I.R. ishte zyrtar i Policisë së Kosovës gjatë vitit 2010. Ai shërbeu si mbikëqyrës i sektorit për dhënien e lejeve për gjueti dhe armëve të gjata. Sipas dëshmitarit personi i cili i ka dhënë rekomandimet për armë të vogla ka qenë Drejtor i Shërbimeve të Brendshme, ndërsa miratimi përfundimtar është dhënë nga Kryesuesi i Divizionit për Administratë dhe Personal.

33. Dëshmitari tha se më 22 shtator 2010 T.C. e thirri atë dhe i kërkoi që t'ia dërgoi asaj tri kërkesat e fundit të cilat janë miratuar. Këto tri kërkesa i përkisnin: A.G., R.A. dhe F.M.. Kur ai i dërgoi këto aplikacione te T.C., kjo e fundit ia ktheu atij kërkesën e A.G., ndërsa ajo i mbajti kërkesat e tjera. Ajo e pyeti dëshmitarin pse Z.K. i ka nënshkruar kërkesën e R.A. në emër të saj, kur ajo ka qenë duke punuar në atë kohë. Dëshmitari u përgjigj se nuk ishte puna e tij që të merrej me nënshkrimet. Dëshmitari deklaroi se Z.K. ishte në pushim prej 20-25 shtator 2010 dhe askush nuk u caktua zyrtarisht për ta zëvendësuar atë. Dëshmitari deklaroi se I.K. e ka zëvendësuar Z.K., derisa ajo ishte në pushim e saj të lindjes, deri në ardhjen e Major H.P.
34. Ky dëshmitar është i besueshëm. Deklarata e tij e vërteton deklaratën e T.C.

***Dëshmia e dëshmitares H.L.***

35. Kjo dëshmitare ka dhënë një deklaratë më 4 shkurt 2011, përpara Prokurorit të PSRK dhe më 3 dhjetor 2014 para trupit gjykues. Dëshmitë ishin në përputhje me njëra-tjetrën dhe në tërësi ishin si vijon:
36. Në shtator të vitit 2010 dëshmitarja punonte në Policinë e Kosovës si oficer e vjetër në njësinë për leje të armëve. Kjo njësi ka katër sektorë: sektori i kompanive private të sigurimit, sektori i armëve me tytë të shkurtë si dhe sektori për armë me tytë të gjatë. Të shumtën e kohës dëshmitarja punonte për sektorin e kompanive private të sigurimeve. Ky sektor si dhe sektori për armë me tytë të shkurtër ndajnë të njëjtën zyre/dhomë. I pandehuri ishte mbikëqyrësi i saj. Dëshmitarja sqaroi procedurën për të siguruar lejen për mbajtje të armës. Ajo deklaroi se parashtruesi i kërkesës duhej të shkonte në zyrën e tyre dhe të plotësonte kërkesën e cila përmbante tri pyetje. Kjo procedurë drejtohej me Rregulloren e UNMIK-ut 2011/7. Sipas dëshmitares Kryesuesi i Departamentit ishte ai që nënshkruante lejen për armë. Ajo nuk e di nëse ndokush tjetër mundte të nënshkruante në emër të kryesuesit të departamentit. Dëshmitarja deklaroi se ajo verifikoi të kaluarën e parashtruesit të kërkesës R.A. dhe kjo u bë kah fundi i gushtit apo fillimi i shtatorit. Ky parashtrues i kërkesës kishte katër

apo pesë raste (raste penale) të cilat figuronin në bazën e të dhënave. Pasi që parashtruesi i kërkesës kishte dosje kriminale ajo kërkoj nga ai që të i siguronte policisë dokumente të tjera lidhur me këtë çështje. Asaj iu dërguan origjinali nga ana parashtruesit të kërkesës, i fotokopjoi ato dhe ia dorëzoi të pandehurit I.K. dhe origjinalet iu kthyen parashtruesit të kërkesës R.A.

37. Dëshmitarja deklaroi se personat që ishin kompetent për të nënshkruar lejet për armë ishin T.C. dhe Z.K. Sipas dëshmitares i pandehuri ishte në pushim vjetor duke filluar nga gushti deri në fillim të shtatorit.
38. Gjykata e sheh këtë dëshmitare të jetë e besueshme. Dëshmia e saj përputhet me deklaratën e E.A., T.C. dhe Z.K.

***Dëshmia e dëshmitarit E.A.***

39. Ky dëshmitar dha dëshmi para Prokurorit të PSRK-së me datë 24 maj 2011 dhe dëshmoi para trupit gjykues me datë 3 dhjetor 2014. Në vijim pason një përmbledhje e dëshmisë së tij:
40. Në shtator të vitit 2010 ky dëshmitar punonte në Policinë e Kosovës. Fillimisht ai ishte nëpunës dhe më pas ai u promovua në oficer për bazën e të dhënave për armë. Megjithëse ai bënte të njëjtën punë para dhe pas promovimit. Dëshmitari dhe H.L. që të dytë kryenin verifikimin e të kaluarës kriminale të parashtruesit të kërkesës. Më vonë për arsye efikasiteti u vendos që E.A. do të kryente verifikimin e të kaluarës kriminale të parashtruesve të kërkesave të sektorit për armë me tytë të shkurtër, ndërsa H.L. do e kryente këtë gjë për kompanitë e sigurimit.
41. Dëshmitari deklaroi para prokurorit se rasti i R.A. ishte një rast urgjent. Si do që të jetë, gjatë shqyrtimit kryesor ai tha se e kishte harruar këtë detaj. Sipas deklaratës së dhënë para prokurorit i pandehuri I.K. i tha atij se ky ishte një rast urgjent.

42. Në deklaratën e tij të dhënë para prokurorit dëshmitari deklaroi se gjersa i pandehuri ishte në pushim, ky i fundit erdhi në zyre dhe pyeti e kërkesën e R.A. Më pas, dëshmitari deklaroi se i pandehuri e morri me vete këtë kërkesë pasi që u informua se punët administrative lidhur me kërkesën ishin kryer. Megjithatë, gjatë dëshmisë së në shqyrtimin kryesor ai tha se ai harroi këtë detaj dhe se kujtesa e tij ishte më e mirë kur ai e dha intervistën para prokurorit.
43. Gjykata e sheh këtë dëshmitar të jetë i besueshëm. Dëshmia e ti përputhet me deklaratën e H.L., T.C. dhe Z.K.

***Dëshmia e dëshmitarit A.R.***

44. Me datë 3 dhjetor 2014 dëshmitari Avni Reçica dha para trupit gjykues shpjegimin si në vijim:
45. Dëshmitari është hetues në Departamentin Special Kundër -Korrupsion, të Policisë së Kosovës. Ai pranoi një kërkesë përmes zinxhirit komandues për të nisur hetimet sepse ekzistonin ca dyshime që nënshkrimet e dy oficerëve të Policisë së Kosovës ishin të falsifikuara. Ekzistonin po ashtu edhe disa dyshime sa i përket përdorimit të vulës.
46. Pasi që u ndërморën disa hapa fillestar të hetimeve dhe hetuesit njoftuan prokurorin lidhur me to, ekipi i hetimeve ishte i mendimit që kishte elemente të mjaftueshme për iniciimin e procedurës penale. Veprimet e tjera u ndërморën sipas autorizimeve të prokurorit si: intervistimi i personave të caktuar, mbledhja e mostrave të nënshkrimeve etj. Shkurtimisht, ekipi i hetimeve mblodhi të gjitha dokumentet e kërkuara nga ane e laboratorit të forensikës. Pas ca kohe laboratorit siguroi rezultatet të cilat më pas iu përcollën prokurorit të PSRK-së.
47. Gjykata e sheh këtë dëshmitar të jetë i besueshëm. Ai dha sqarime mbi hapat hetimor që u kryen gjatë fazës së procedurës paraprake. Dëshmia e tij vetëm sqaroi raportin i cili ishte përgatitur gjatë fazës së hetimeve.

*Dëshmia e dëshmitares eksperte N.I.*

48. Dëshmitarja eksperte dëshmoi para trupit gjykues se me datë 19 shkurt 2015. Gjatë dëshmisë së saj ajo sqaroi raportin e ekspertizës i cili ishte përgatitur me datë 4 tetor 2011. Dëshmitarja eksperte nxjerri në përfundim me sa vijon:

Nënshkrimi në dokumentin 02B0075;

Nënshkrimi në rreshtin e dytë të dokumentit 10B0091;

Nënshkrimi në rreshtin e dytë të dokumentit 10C0053;

Nënshkrimi në rreshtin e parë të dokumentit 10B0084;

Nënshkrimi në rreshtin e dytë të dokumentit 10C0026;

Nënshkrimi në dokumentin e quajtur “Rekomandim për Leje të Armës”  
10B0084;

Nënshkrimet e sipër përmendura të krahasuara me mostrat nga prova 2 dhe 8, të cilat mostra janë të Z.K. dhe gjegjësisht të T.C., mes tyre nuk është vu re asnjë karakteristik individuale apo e përgjithshme. Në të njëjtën kohë ekspertiza nxjerr si përfundim se nënshkrimet e sipër përmendura kishin karakteristika individuale dhe të përgjithshme që përputhen me mostrat 4 dhe 6, që të dyja mostrat janë të të pandehurit I.K.

49. Ekspertiza më tej nxjerr si përfundim se nënshkrimi në pjesën e dytë të dokumentit 10B0084 nuk përputhet me asnjërën nga mostrat sepse nuk ka karakteristika të mjaftueshme për të bërë krahasimin, si me shkronja aq të kufizuara, mungesën e karakteristikave identifikuese, nënshkrimet nuk janë shkruar në mënyrë natyrale etj.
50. Gjykata e sheh deponimin e dëshmitares eksperte si provë absolutisht bindëse. Ajo sqaroi në hollësi se si arriti tek ky përfundim në raportin e ekspertizës me shkrim.
51. Raporti me shkrim i përgatitur nga ana e ekspertes është i shkruar në mënyrë profesionale dhe bindëse. Gjykata e sheh këtë raport të ekspertizës si një

dokument të besueshëm dhe të sigurt i cili i ndihmoj gjykatës në marrjen e një vendimi të drejtë në këtë lëndë.

52. Vetë ekspertja është profesioniste dhe ajo është trajnuar një vit nga FBI-ja në vitin 2007. Më pas ajo është certifikuar si eksperte dhe qysh nga ajo kohë ajo punon në këtë profesion. Që nga viti 2008 ajo ka kryer çdo vit përafërsisht njëzet (20) ekspertiza të këtij lloji. Prandaj, gjykata vjen në përfundim se ekspertja është profesioniste dhe e besueshme.

### ***Dëshmia e të pandehurit I.K.***

53. Me datë 18 mars 2011 i pandehuri I.K. dha këtë shpjegim para prokurorit të PSRK-së e cila më vonë është vërtetuar nga ai gjatë shqyrtimit kryesor me disa përjashtime:
54. I pandehuri është oficer i policisë që punon në Policinë e Kosovës. Gjatë vitit 2010 ai shërbeu si Kryesues i Njësitit për Leje të Armëve. Përgjegjësitë kryesore të të pandehurit ishin që të menaxhonte njësitin. Puna kryesore ishte që të kompletoj dosjen për kërkesa ku kërkohej një leje për mbajtje të armës. Pasi që dosja kompletohej atëherë ishte përgjegjësia e tij që të siguronte rekomandimet lidhur me vendimet e pranimit apo refuzimit të kërkesave. Sipas të pandehurit, në mungesë të mbikëqyrësve të tij, ai kishte të drejtë të vendoste se a të pranonte apo ta refuzonte një kërkesë të caktuar. I pandehuri deklaroi se në bazë të rregullores në fuqi ekzistonin dy kritere për të lejuar dikë që të mbante një armë brezi: 1) parashtruesi i kërkesës duhet të ketë të kaluar të pastër kriminale dhe 2) duhet të jetë i prekshëm.
55. Sipas të pandehurit përgjegjësia e tij kryesore ishte që të kompletoj dhe verifikoj secilin dokument në dosje të lëndës, dhe pastaj të jap një rekomandim dhe më pas ta kaloj kërkesën në instanca më të larta – Drejtorit të Drejtorisë për Shërbime të Brendshme – për nënshkrim. Në mungesë të drejtorit i pandehuri do të kryej këto detyra. Sipas të pandehurit kur nuk punonte Z.K. ai e zëvendësonte atë. Kur ajo mungonte në punë për një periudhë të shkurtër kohore



i pandehuri nënshkruante në emër të saj me një “për” para nënshkrimit, ndërsa kur ajo mungonte për një periudhë më të gjatë kohore i pandehuri nënshkruante në emër të saj pa këtë “për”, sepse ai ishte ushtrues detyre si drejtor.

56. Sa i përket kërkesës së R.A.t i pandehuri deklaroi se ai dha rekomandim pozitiv për kërkesën e tij por se kjo ishte bërë në praninë e dëshmitares Z.K. dhe se kjo ishte bërë në zyrën e të pandehurit. Sipas të pandehurit Z.K. tha se R.A. ka një rast penal por se ky rast ishte parashkuar.
57. I pandehuri pohoi se që të dy nënshkrimet në dokumentin 02B0075 ishin të Z.K.
58. I pandehuri pohoi se asnjëri nga nënshkrimet në dokumentin 10B0084 ishin të tij.
59. I pandehuri pohoi se nënshkrimi në rreshtin e parë në dokumentin 10B0091 ishte i tij, ndërsa nënshkrimi në rreshtin e dytë ishte i Z.K. Ai pranoi se dokumenti kishte nënshkrimin e tij.
60. I pandehuri pohoi se nënshkrimi në rreshtin e parë në dokumentin 10C0053 ishte i tij, ndërsa nënshkrimi në rreshtin e dytë ishte i Z.K. Ai nuk ishte në gjendje të tregoj se cila vulë ishte përdorur në këtë dokument.
61. I pandehuri pohoi se nënshkrimi në rreshtin e parë në dokumentin 02B0075 ishte i tij.
62. Pretendimet e të pandehurit janë hedhur poshtë nga gjetjet e ekspertizave, deklaratat e dëshmitarëve T.C. dhe Z.K., dëshmia e E.A. dhe H.L. Nga të gjitha provat e dosjes së lëndës u sqarua se dëshmitari nënshkroi dokumentet e kontestuara pa pasur autorizim të duhur për të bërë një gjë të tillë dhe pa asnjë autorizim që të nënshkruaj në emër të autoriteteve. Ai me qellim futi përmbajtje të rrejshme në dokumentet e përmendura në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

### ***Provat materiale***

63. Dosja e lëndës përmban dokumente të tjera që janë proceduar gjatë vazhdës së hetimeve por të cilat nuk janë relevante për qëllime të vërtetimit të fakteve të kësaj lënde.

#### **VI. Kualifikimi Ligjor:**

64. Akuza 1 e përmbledhjes së aktakuzës thotë se vepra penale me të cilën ngarkohet i pandehuri ndodhi në muajin shtator të vitit 2010. Vepra penale e Keqpërdorimit të Pozitës Zyrtare është e dënueshme deri në një vit burgim sipas nenit 339 (1) të KPK-së së vitit 2003, dhe me 3 muaj deri në 3 vite sipas nenit 442 të Kodit Penal të Kosovës ('KPK'). Prandaj KPK-ja e vitit 2003 është zbatuar si ligji më i favorshëm për të pandehurin. Afati i parashkrimit për një vepër penale të dënueshme deri në një vit burgim është 2 vite. Ndjekja penale do të parashkruhet për çdo rast kur dyfishi i afatit të parashkrimit ka kaluar (neni 91 (6) KPK-ja e vitit 2003). Vepra penale e Keqpërdorimit të Pozitës Zyrtare siç pretendohet në Akuzën 1 është kryer në muajin shtator të vitit 2010. Dyfishi i afatit të parashkrimit ka kaluar prandaj Akuza 1 refuzohet.
65. Lidhur me Akuzën 2 të aktakuzës gjykata ka vërtetuar faktet siç janë paraqitur në dispozitiv. Këto fakte, që do të thotë falsifikimi i dokumenteve zyrtare të Policisë së Kosovës konsumojnë të gjitha faktet të veprës penale të **Falsifikimit të Dokumenteve Zyrtare** në kundërshtim me nenin 348 (1) të KPK-së së vitit 2003. Prandaj, gjykata kualifikoi këto veprime siç janë përcaktuar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.
66. Gjykata gjen se Kodi Penal (2003) është më i favorshëm për të pandehurin sepse dispozitivi i këtij kodi përcakton se dënimi për këtë vepër penale është burgimi prej tre (3) muajve deri në tre (3) vjet, ndërsa Kodi i ri Penal (2013) për të njëjtën vepër penale parasheh dënim me burg prej gjashtë (6) muajve deri në pesë (5) vjet.
67. Prandaj, në bazë të nenit 3(2) të KPK-së (2013), ligji material i aplikueshëm për këtë rast është Kodi Penal i Kosovës (2003).

## **VII. Dënimi:**

68. Gjykata, sipas nenit 64 të KPK-së (2003), mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese kur vendosi të caktoj dënimin ndaj të pandehurit. Sipas nenit 348(1) të KPK-së (2003) shtrirja e dënimit për kryerjen e veprës penale **Falsifikim i Dokumenteve Zyrtare** nga tre muaj deri në tre vite burgim.
69. Si rrethanë lehtësuese në rastin aktual është marr parasysh sjellja korrekte e të pandehurit përgjatë procedurës penale. Veç kësaj ai është një person familjar dhe afër pensionimit.
70. Si rrethanë rënduese gjykata mori parasysh faktin që i pandehuri lëshoi leje për mbajtje të armëve e që janë vendime shumë të ndjeshme.
71. Duke marr parasysh të gjitha këtyre elementeve gjykata është e mendimit se një vit burg, dhe të jesh i suspenduar për dy vite, është një masë proporcionale në këtë rast kur kjo kombinohet me gjobën që është vënë.

## **VIII. Shpenzimet e procedurës penale gjyqësore:**

72. Sipas nenit 450(2) dhe 453(1) të KPP-së i pandehuri është i obliguar të paguaj shpenzimet e procedurës penale gjyqësore në shumë prej 150 Eurosh të cilat duhen të paguhen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas që aktgjykimi të merr formën e prerë.

## **IX. Kërkesa pasurore juridike:**

73. Pasi që informatat e mbledhura në këtë procedurë penale gjyqësore nuk sigurojnë baza të besueshme për një shpërblim të plotë ose të pjesshëm, gjykata në bazë të nenit 463(2) të KPPK-së vendosi të udhëzoj palën e dëmtuar që të ndjek të gjithë kërkesën pasurore juridike padinë pronësore në procedurën civile.

## **X. Përfundim:**

74. Duke pasur parasysh argumentet e cekura si më sipër gjykata vendosi si në këtë dispozitiv.

---

Mariola Pasnik,  
Kryetare e trupit gjykues

---

Muhamet Musliu  
Procesmbajtës

**MJETI JURIDIK:** Personat e autorizuar (i pandehuri, prokurori dhe pala e dëmtuar) mund të parashtrajnë ankesë kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Apelit përmes kësaj gjykate. Ankesa mund të parashtrohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita që palëve iu është dërguar një kopje e këtij aktgjykimi me shkrim.